

AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Sot në datën 04/10/2022 në selinë e përcaktuar për ushtrimin e aktivitetit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Twin Towers, Kulla II, kati IV, hyrja II, Tiranë, personat si më poshtë vijon:

1. **Z. Mario Artur Qato**, lindur në Tiranë, më 26/08/2000, me numër ID K00826052I, banues në Tiranë, në rrugën “Dora Distria, Nd. 1831, njësia administrative nr. 5.
2. **Z. Edmond Daut Sinani**, lindur në Roskovec, më 04/06/1984, me numër ID I40604030C, banues në Tiranë, në rrugën “Bilal Xhaferri”, ndërtesa 1, hyrja 23, apt 9, njësia administrative nr. 5.

Mbështetur në ligjin nr 9901 dt 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, vendosën themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar si më poshtë vijon:

KREU I

Neni 1

Emërtimi i Shoqërisë, Logo dhe Vula

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar do të ketë emërtimin **SonConsulting Engineers shpk**.
2. Shoqëria **SonConsulting Engineers shpk**, fiton personalitet juridik pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe organet përkatëse dhe do të ushtrojë veprimtarinë e saj sipas këtij AKTI THEMELIMI, STATUTI dhe sipas legjislacionit në fuqi.
3. Logo e shoqërisë perbehet nga sfondi i gjelbërt në ngjyrë të errët, inicialet **SC** dhe emërtimi **SonConsulting Engineers shpk**.
4. Shoqëria do të ketë vulën e saj të përbërë nga logo dhe emri i shoqërisë.

Neni 2

Forma Ligjore

1. **SonConsulting Engineers shpk** është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila është themeluar, organizuar dhe ushtron aktivitetin e saj sipas ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.



Neni 3
Zyra Qëndrore

1. Zyra qëndrore për ushtrimin e veprimtarisë së shoqërisë është në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Twin Towers, Kulla II, kati IV, hyrja II, Tiranë.
2. Administratorët e shoqërisë mund të vendosin hapjen e degëve dhe/ose të zyrave të përfaqësimit të shoqërisë.
3. Degët dhe zyrat e përfaqësimit janë vende të ushtrimit të veprimtarisë tregtare dhe kanë të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë. Ato veprojnë në mënyrë të qëndrueshme, organizohen dhe administrohen më vete dhe ushtrojnë veprimtari me palë të treta, në emër të shoqërisë.

Neni 4
Objekti i Aktivitetit

1. Objekti i aktivitetit të shoqërisë është:
 - a) Studim dhe Projektim objektesh në ndërtim:
 - i. Projektim urbanist: plane kombëtare sektoriale; plane të detajuara për zona të rëndësisë kombëtare; plane sektoriale në nivel qarku/bashkie; plane të detajuara vendore.
 - ii. Projektim arkitekturor: projektme arkitekurore për objekte banimi; objekte industriale; objekte turistike; objekte sportive; qendra tregtare; objekte social-kulturore; objekte arsimore; objekte spitalore; terminallet në infrastrukturë; vepra arti në infrastrukturë; projektim interiere; projektim peizazhi; sipërfaqe të gjelbërta.
 - iii. Projektim konstruktor: objekte civile – industriale – turistike deri në 5 kate dhe mbi 5 kate; vlerësim i kapacitetit mbajtës dhe strukturave mbajtëse prej betoni/murature/metallike; objekte civile e turistike prej druri.
 - iv. Projektim instalator: projektim i instalimeve hidro-termosanitare; termoteknike-kondicionimi; impianteve të prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme; projektim të linjave e rrjeteve elektrike për objekte civile e industriale; sistemeve të telekomunikacionit; sistemeve të furnizimit me gas; projektim të sistemeve kundra zjarrit; projektim të sistemeve monitoruese në industri dhe ndërtesa; projektim i impianteve ngritëse e transportuese; projektim i ndriçimit rrugor; shesheve; dekorative; objekteve sportive; porteve; aeroportive etj.; projektim i rrjeteve të telefonisë; internetit; TV; sistemeve të alarmit, sistemeve të dedektimit të zjarrit etj.
 - v. Projektim veprash hidraulike: diga të mëdha; furnizim me ujë; ujësjellës kanalizime urbane/rurale; vepra ujitje, kullimi, impiante vaditëse; vepra të trajtimit të ujit; vepra hidroteknike galeri e tunele hidraulike; vepra naftësjellës, gazsjellës etj; porte.



- vi. Projektim rruge – hekurudha: rrugë lokale; rrugë urbane dytësore, interurbane dytësore; rrugë urbane kryesore dhe interurbane kryesore; autostrada; aeroporte; helioporte; hidroporte; hekurudha; degëzime hekurudhore.
 - vii. Projektme urash dhe veprash arti: ura dhe vepra arti të vogla; ura dhe vepra arti mbi 10m etj, ura të varura; ura metalike; tunele hekurudhore.
 - viii. Projektme gjeodezie: rilevime inxhinierike; rilevime inxhinierike kadastrale; sisteme GIS; bazamente gjeodezie; projektim fotogrametrik dhe hartografik.
 - ix. Projektim i impianteve të shpërndarjes së energjisë elektrike: centrale hidraulike, trmike, impiante të prodhimit të energjisë së rinovueshme, nënstacione elektrike, kabina elektrike.
 - x. Prokjektim të sinjalistikës rrugore;
 - xi. Studime të projektmeve të ndërtimit dhe depozitimit të mbetjeve të ngurta;
 - xii. Studime e projektme të ndërtimeve të impianteve të trajtimit të ujrave të zeza.
- b) Mbikqyrje dhe kolaudim të punimeve të zbatimit në ndërtim:
- i. mbikqyrje dhe kolaudim punimesh: gërmimi; ndërtimesh civile dhe industriale; rikonstrukcion dhe mbirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash; rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, pista aeroportuale; punime nëntokësore, ura, vepra arti, diga, ujësjellës kanalizime, vepra vaditje e kullimi; vepra naftësjellës-gazsjellës; ndërtime detare; ndërtime të impianteve të prodhimit të energjisë elektrike; punime të inxhinierisë së ndërtimit;
 - ii. mbikqyrje dhe kolaudim punimesh: për prishjen e ndërtimeve; impiande hidro-sanitare; impiante ngritëse dhe transportuese; punime rifinure të muraturës dhe të lidhura me to; impiante të sinjalistikës ndruçuese të trafikut; barrier dhe mbrojtje rrugore; ndërtimesh parafabrikat beton arme; struktura metalike; struktura druri; punimesh strukturore special; punimesh mbi shina; impiante teknologjike' linja telefonike etj.; impianteve të trajtimit të ujrave të pijshëm trajtimit të tij; impiante të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane impiante të trajtimit të ujrave të zeza; sistemeve kundra zhurmës; punimeve topogjeodezike etj.
- c) Vlerësimin e pasurive të paluajtshme dhe konsulencë juridike.
 - d) Import – eksport, tregëti me shumicë e pakicë të produkteve industriale, materialeve të ndërtimit, produkteve ushqimore etj.
 - e) Shërbime ekspertize profesionale lidhur me ndikimin në mjedis.
 - f) Shërbime konsulente të planeve të përgjithshme vendore dhe planifikimit urba. topografike, gjeologjike etj.
 - g) Pjesëmarrje në tendera publike-private të lidhura me objektin e shoqërisë.
2. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë mund të zgjerohet më tej, ose të ndryshohet me vendimin e organeve përkatëse të shoqërisë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Ndalimi i Konkurrencës

1. Ortakët, administratorët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqërinë e parë. Gjithashtu, këta persona nuk mund të mbajnë statusin e tregtarit për të ushtruar veprimtari në këtë sektor.
2. Nëse ndonjëri prej personave të përmendur në pikën 1 të këtij neni shkel ndalimin e konkurrencës, shoqëria mund:
 - a) ta përjashtojë atë nga shoqëria apo ta shkarkojë nga detyra;
 - b) të kërkojë ndërprerjen e veprimtarisë konkurruese;
 - c) të ngrejë padi për shpërblimin e demit.

Neni 6 Sekreti Tregtar

1. Sekreti tregtar është një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument, që shoqëria mbron në mënyra të përshtatshme, i cili, nëse do t'u përhapej personave të paautorizuar, do të shkaktonte dëm të konsiderueshëm të interesave tregtarë të shoqërisë.
2. Personat e pranuar në shoqëri, duhet që të mos ekspozojnë tek asnjë person i jashtëm informacionet që do të disponojë shoqëria, kontratat që mund të lidhë, apo cdo lloj material, si dhe planifikimet dhe qëllimet e shoqërisë.

Neni 7 Kohëzgjatja e Shoqërisë

1. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë kohe të pacaktuar, që fillon nga regjistrimi i saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
2. Prishja dhe likuidimi i shoqërisë do të bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kreu II

KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË DHE KUOTAT

Neni 8 Kapitali Themeltar

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 lekë.
2. Pjesëmarrja në kapitalin e shoqërisë është: **Z. Edmond Sinani 49000 lekë** dhe **Z. Mario Qato 51000 lekë**.
3. Kapitali fillestar mund të shtohet ose të pakësohet me vendim të asamblesë së përgjithme sipas përcaktimeve në ligjin 9901 dt 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".



Neni 9
Kuotat

1. Kapitali i shoqërisë është i ndarë në **2 kuota**
2. Kuotat e shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre, mund të fitohen apo transferohen me anë të:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
 - b) shitblerjes
 - c) trashëgimisë
 - d) dhurimit
 - e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.
3. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, ajo bëhet në formë të shkruar.
4. Në rast se njëri nga ortakët, do të trasferojë kuotat e tij, apo një pjesë të tyre, me anë të shitblerjes, ai duhet t'ja ofrojë këto kuota fillimisht ortakut tjetër.

Neni 10
Pronësia mbi Kuotat

1. Pronësia mbi kuotat është si më poshtë vijon:
 - a) **Z. Mario Qato zotëron 1 kuotë.**
 - b) **Z. Edmond Sinani zotëron 1 kuotë.**

KREU III
MARRËDHËNIET MIDIS SHOQËRISË DHE ORTAKËVE

Neni 11

Shpërndarja e Fitimeve

1. Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.
2. Fitimi u shpërndahet ortakëve në mënyrë të barabartë.

Neni 12

Kufizimet e shpërndarjeve, certifikata e aftësisë paguese

1. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:
 - a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj.
 - b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.



2. Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 1 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.
3. Kërkesat e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, zbatohen gjithashtu në rastet kur, pavarësisht nga dhënia e miratimeve të nevojshme, sipas nenit 13, të ligjit nr 9901 dt 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, shoqëria do të kryejë një pagesë në favor të një prej ortakëve të saj, në bazë të një marrëveshjeje të lidhur mes shoqërisë dhe ortakut, e cila përmban kushte më pak të favorshme për shoqërinë, në krahasim me kushtet normale të tregut.
4. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese që duhet të lëshohet sipas këtij neni.

Neni 13

Përgjegjësia personale për shpërndarjet e ndaluara

1. Administratorët, të cilët nga pakujdesia lëshojnë një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, sipas pikës 2 të nenit 77 të ligjit, përgjigjen personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë.
2. Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u janë shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur, pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, sipas pikës 1 të nenit 77 ligjit nr 9901 dt 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ose në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishin pasur dijeni për këtë gjendje.

Neni 14

Rikthimi i shpërndarjeve të ndaluara

1. Paditë e shoqërisë, siç parashikohet në nenin 78 të ligjit nr 9901 dt 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, mund të ngrihen edhe sipas pikës 3 të nenit 10 të këtij ligji.
2. Parashkrimi i padive, sipas pikës 1 të këtij neni, nis në datën kur është kryer shpërndarja e ndaluar.

KREU IV

ORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 15

Organet e Shoqërisë dhe Administrimi



1. Organet e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar janë:
 - a) Asambleja e Përgjithshme.
 - b) Administratori.

Neni 16 Asambleja e Përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "g" dhe "h" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

Neni 17 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji 9901 dt 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare", nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të këtij ligji 9901 dt 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
3. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim.
4. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.



5. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 e 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur.

Neni 18 **Mënyra e Thirrjes**

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
3. Ortakët, të cilët nuk janë të pranishëm, mund të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, duke përfshirë edhe mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.
4. Mjetet/mjetet elektronike përfshijnë, por nuk kufizohen në:
 - a) transmetimin në kohë reale të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme;
 - b) komunikimi i ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vend tjetër;
 - c) mekanizmat që mundësojnë procesin e votimit, para ose gjatë mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja e caktimit të një përfaqësuesi të autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.
5. Përdorimi i mjeteve/mjeteve elektronike, për të mundësuar pjesëmarrjen e ortakëve në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kusht që të merren masat e nevojshme teknike për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, në masën që ky përdorim duhet të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

Neni 19 **Kuorumi**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.



2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 20

Marrja e vendimeve

1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
2. Për çështjet e tjera të renditura në nenin 10 të këtij statuti, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.
3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

Neni 21



E Drejta e Votës

1. Çdo ortak ka të drejta vote në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij.
2. Ortakët, që nuk janë të pranishëm, kanë mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.
3. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:
 - a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
 - b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;
 - c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.
4. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që ky përdorim të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.
5. Ortakët kanë të drejtën, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

Neni 22

Përjashtimi nga e Drejta e Votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:



- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortakët përfaqësohen nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortakët, të cilin përfaqëson.

Neni 23

Procesverbalet e mbledhjes së asamblesë

1. Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.
2. Procesverballi duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.
3. Procesverballit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
4. Procesverballi i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.
5. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

Neni 24

Administrimi i Shoqërisë

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
2. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.
3. Administratori i shoqërisë është:
 - a) **Z. Edmond Sinani**, për një mandat 5-vjecar nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB, me të drejtë ripërtëritjeje.

Neni 25

Detyrat e Administratorit

1. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:
 - a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;



- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj.
2. Administratori ka detyrimin që të thërrasi assamblenë e përgjithme, nëse sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
3. Administratori ka detyrimin që të thërrasi assamblenë e përgjithme, nëse shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Neni 26

Detyrimi i Besnikërisë dhe Përgjegjësia e Administratorit

1. Administratori detyrohet:
- a) të kryejnë detyrat e përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - e) të ushtrojë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e

lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryen veprimet e mëposhtme:
 - a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - e) jep kredi.
5. Padia për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga veprimet/mosveprimet e administratorit në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësitë e tij të përcaktuara me ligj, duhet të ngrihen brenda 3 vjetëve nga kryerja e shkeljes apo nga zbulimi i saj.

KREU V LIBRAT E SHOQËRISË, BILANCI

Neni 27 Librat e Shoqërisë

Shoqëria është e detyruar të mbajë, përveç Librit të Shoqërisë në të cilin shënohet emri i plotë i ortakëve, kapitali themeltar, vendimet asamblesë së përgjithshme si edhe dokumentacionin kontabël dhe librat e tjerë.

Neni 28 Bilanci

1. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti. Bilanci mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti.
2. Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar, raportet e hartuara nga eksperti kontabël i autorizuar, propozimet për ndarjen e fitimeve, nënshkruhen nga administratori dhe miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e ortakëve.
3. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore behet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.



KREU VI

PRISHJA E SHOQËRISË, LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE

Neni 29

Shkaqet e Prishjes së Shoqërisë

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:
 - a) me vendim të asamblesë së përgjithshme,
 - b) me hapjen e procedurave të falimentimit,
 - c) me vendim të gjykatës,
 - d) për arsye të tjera të përcaktuara në ligjin “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
2. Administratorët regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Neni 30

Largimi i Ortakut

1. Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.
2. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrojë shkaqet e largimit.
3. Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, sipas pikës 2 të këtij neni, për të vendosur nëse ortakut do t’i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.
4. Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mblidhet apo nuk i njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.
5. Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.
6. Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrejë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar.

Neni 31

Përrjashtimi i Ortakut



1. Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.
2. Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, sipas pikës 1 të këtij neni, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortakut:
 - a) me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
 - b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
 - c) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut; ose
 - d) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.
3. Gjatë procedurës së përjashtimit të ortakut, me kërkesë të paditësit, gjykata mund të marrë një masë për sigurimin e padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut, që kërkohet të përjashtohet, si dhe të drejtat e tjera, që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, kur ajo e vlerëson këtë masë si të nevojshme dhe të justifikuar.
4. Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.
5. Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.
6. Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortakut ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.
7. Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhet në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të gjykatës për largimin ose përjashtimin.

Neni 32

Likuidimi në gjendjen e aftësisë paguese

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 33

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

1. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve mes ortakëve do të orientohet drejt mënyrave alternative të zgjidhjes, përpara se palët t'i drejtohen gjykatës.



2. Nëse mënyrat alternative nuk rezultojnë efektive, palët mund t'i drejtohen Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 34

Dispozita të fundit

1. Ky Statut dhe Akt Themelimi, është hartuar sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe çdo interpretim i dispozitave të tij, do të bëhet mbi bazën e këtij legjislacioni.
2. Dispozitat e ligjit 9904, dt 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” do të zbatohen për çdo rast që nuk parashikohet në statut.
3. Statuti dhe Akti i Themelimit përpilohen në 3 kopje origjinale, në gjuhën shqip dhe nënshkruhen në çdo fletë prej ortakëve themelues të saj, pasi të lexohet dhe të deklarohet nga ata se e aprovojnë si të tillë.
4. Me mundësinë që të shtohen dispozita të tjera sipas kushteve të zhvillimit të shoqërisë dhe akteve ligjore në fuqi, ky Statut dhe Akt Themelimi, i bashkohen dokumentave të tjerë themeltarë të kësaj shoqërisë.

ORTAKËT THEMELUES

MARIO QATO

Mario Qato



EDMOND SINANI

